



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

KF.nr.100/22

GJYKATA KOMERCIALE, Dhomat e shkallës së parë, Departamenti Fiskal, me gjyqtarin Fisnik Nuli, dhe me këshilltaren profesionale Blerina Qafleshi Baxhaku, në kontestin tregtar - administrativ, të paditësit N.T.SH “G...”, me seli në Rahovec, të cilin sipas autorizimit e përfaqëson Naim Spahiu, Avokat në Prishtinë, kundër të paditurit Dogana e Kosovës në Prishtinë, me bazë juridike - anulim vendimi, objekt kontesti - rivlerësim malli, vlerë kontesti 1,367.51 €, në seancën e shqyrtimit gjyqësor kryesor publik të mbajtur me datë 10.11.2022, në prani të përfaqësuesit të autorizuar të paditësit Avokat Naim Spahiu, dhe të përfaqësuesit të autorizuar të palës së paditur B.S, mori këtë:

A K T G J Y K I M

- I. APROVOHET kërkesëpadia e paditësit N.T.SH “G...”, me seli në Rahovec, të cilin sipas autorizimit e përfaqëson Naim Spahiu, Avokat në Prishtinë, si e bazuar.
- II. ANULOHET vendimi nr.01.3.2.2/5692 i datës 19.06.2020 i Doganës së Kosovës dhe lënda KTHEHET NË RISHQYRTIM DHE RIVENDOSJE.
- III. Secila palë i bartë shpenzimet e veta procedurale

A R S Y E T I M

Paditësi N.T.SH “Genci Af”, me seli në Rahovec, me padinë e paraqitur në Gjykatë me datë 05.08.2020, ka iniciuar kontestin tregtar - administrativ kundër të paditurës Dogana e Kosovës në Prishtinë, kundër aktvendimit nr.01.3.2.2/5692 i datës 19.06.2020, duke i propozuar gjykatës që të aprovohet kërkesëpadia e paditësit N.T.SH “G...”, me adresë Nagavc-Rahovec, dhe të anulohet aktvendimi i Doganës së Kosovës nr.01.3.2.2/5692 i datës 19.06.2020, si dhe të obligohet e paditura Dogana e Kosovës që paditësit t’ia paguajë shpenzimet e procedurës gjyqësore.

Në seancën e shqyrtimit kryesor dhe në fjalën përfundimtare përfaqësuesi i autorizuar i paditësit ka deklaruar se : Paditësi ka paraqitur të gjithë dokumentacionin e kërkuar me kodin doganor dhe të akcizave si dhe UA 06/2015 dhe se vendimi kontestues i të

paditurës nuk është i bazuar në KDA. Paditësi ka paraqitur faturën e mallit packing listën transferet bankare në të cilët dëshmon se çmimi i mallit është vlerë reale e paguar edhe për kundër të gjitha dokumentacionit të dorëzuar e paditura anashkalon këtë dokumentacion dhe ë bën rivlerësimin e mallit me metodën e 6 të vlerësimit. Vendimi i atakuar është në kundërshtim të plotë me nenin 33 dhe 34 te KDAK-së. Marr parasysh të gjitha të lartcekurat i propozojmë gjykatës që padia e paditësit të aprovohet në tërësi, të anulohet vendimi kontestues nt.01.3.2.2/5692 i datës 19.06.2020 dhe të obligohet e paditura Dogana e Kosovës që paditësit t'ia kthej shumen prej 1,367.51 euro, në emër të rritjes së detyrimeve doganore dhe atë me kamatë ligjore prej 8% prej datës së pagesës së detyrimeve doganore deri në kthimin definitiv të tyre.

E paditura, në përgjigje në padi të datës 07.07.2021 e konteston në tërësi si të pa bazuar padinë dhe kërkesëpadinë e paditësit, duke theksuar se aktvendimi i atakuar është marr komfor të gjitha dispozitave në fuqi dhe ajo në të cilën pretendon pala se ky vendim është marrë me shkelje ligjore nuk qëndron fare, me arsyetimin se vendimi i atakuar është marrë konform legjislacionit në fuqi dhe në mënyrë të drejtë, ndërsa pala paditëse pretendimet e veta nuk i ka vërtetuar as edhe me një provë të vetme. Po ashtu, e paditura ka theksuar se e njëjta pasi ka pranuar padinë dhe pretendimet e paraqitura, të njëjtat i ka trajtuar në aktvendimin kontestues një nga një dhe të gjitha së bashku, dhe pikërisht për faktin se nuk janë prezantuar prova të mjaftueshme dhe të harmonizuara nga ana e paditësit gjatë trajtimit të lëndës në procedurë administrative, është refuzuar kërkesa e subjektit për rishqyrtimin e vendimit kontestues.

Përfaqësuesi i autorizuar i të paditurës në seancën e shqyrtimit kryesor dhe në fjalën përfundimtare ka deklaruar se : Aktvendimi i sjell nga dogana e Kosovës është konform dispozitave ligjore ne fuqi dhe nuk qëndron pretendimi i paditësit se i njëjti është marr me shkelje ligjore. Deri te rivlerësimi i mallit ka ardhur pasi që nuk është prezantuar dokumentacioni i nevojshëm dhe i harmonizuar për të dëshmuar vlerën e paguar apo të pagueshme për mallin gjithnjë duke pasur parasysh që dogana e Kosovës ka disponua të dhëna se vlera a mallit është dukshëm më e lartë, andaj edhe vlerësimi është bërë konform dispozitave të nenit 35 te KDA-së. Nuk qëndron pretendimi i paditësit se aktvendimi është sjell në kundërshtim me dispozitat e nenit 47 dhe 48 të LPA-së, pasi që i njëjti ka respektuar formën dhe strukturën e aktit të përcaktuar në LPA si dhe përmban arsyetimin e nevojshëm bazuar në fakte dhe argumentet që arsyetojnë

dispozitivin e aktit. Sa i përket dokumentacionit të prezantuar dogana ka evidentuar se mungon deklarata eksportuese, kontrata e shitblerjes si dhe në faturë mungojnë informacionet e nevojshme lidhur me llogarinë bankare ku duhet të bëhet pagesa e mallit, siç është standard i marrëdhënieve tregtare i përmbushjes së këtij kriteri sa i përket llogarisë bankare të përshkruar në faturë. Rrjedhimisht paditësi nuk ka arritur t'i dëshmoj doganës së vlera e prezantuar është vlerë reale e mallit. Sa i përket pretendimi të paditësi se e ka ofruar të gjithë dokumentacionin e nevojshëm, konsiderojmë se është i paqëndrueshëm pasi që siç është potencuar edhe në aktvendimin e kontestuar Dogana ka gjetur të dhëna se malli i ngjashëm nga i njëjti shtet eksportues dhe i origjinës është importuar me vlerë me të lartë se sa vlera e deklaruar nga paditësi, dhe paditësi do të duhej që të prezantonte kontratën e shitblerjes përmes së cilës do të argumentoj se cilat janë arsyet që malli në fjalë i është ofruar me vlerë me të ulët se sa blerësve të tjerë të mallit të ngjashëm. Vlera është e njëjtë me vlerën e nxjerr nga sistemi ASYCUDA të cilin ne e posedojmë. Shpenzimet e procedurës nuk i kërkon.

Me qëllim të vërtetimit të drejtë dhe të plotë të gjendjes faktike, Gjykata në procedurën e provave të shqyrtimit gjyqësor kryesor-publik, ka administruar provat dhe atë: aktvendimin 5692/19.06.2020, ankesën e ushtruar në Doganën e Kosovës e datës 19.05.2020, DUD-at nr.22541/07.05.2020, 55383/04.09.2019, 37046/11.12.2019, Faturë nr.KD20E004, Packing List të datës 23.03.2020, faturat e shitjeve të shpenzimeve të transportit nr.2006 dhe nr.2003, CMR, Urdhërpagesat ndërkombëtare me status të përgatitur të datës 14.01.2020 dhe 15.04.2020 së bashku me SWIFT Konfirmimet, deklarata T2 e datës 05.05.2020, procesin mbi përcaktimin e vlerës së mallrave të datës 06.05.2020, si dhe përgjigjen në padi të datës 07.07.2021.

Gjykata vlerësoi ligjshmërinë e vendimit kontestues, thëniet në padi dhe seancë, përgjigje në padi, shkresave të lëndës në këtë konflikt administrativ, bëri ballafaqimin e provave që kanë ofruar të dy palët, dhe bëri vlerësimin e secilës provë veç e veç dhe të gjithave së bashku, mbështetur edhe në dispozitat nga neni 8, të Ligjit për Procedurën Kontestimore (LPK-së), dhe arriti në përfundimin se në këtë konflikt administrativ, duhet vendosur si në dispozitiv të këtij aktgjykimi, për këto arsye:

Nga provat e administruara në këtë konflikt administrativ, nga DUD-i kontestues i Doganës së Kosovës, deklarimeve në padi, shkresat e lëndës, aktvendimi kontestues, dhe deklarimeve në seancën e shqyrtimit kryesor, Gjykata ka gjetur se nuk është kontestues

fakti se paditësi ka paraqitur DUD-in R-22541 të datës 06.05.2020, për zhdoganim pranë ZBD Prishtinë, me ç'rast i njëjti është proceduar, duke u ri-vlerësuar bazuar në metodën e 6-të. Jo kontestuese mbetet edhe fakti se paditësi ka ushtruar ankesë pranë Doganës së Kosovës, e për të cilën ankesë, Dogana e Kosovës me datë 19.06.2020, ka sjell Aktvendimin nr.01.3.2.2/5692, si akt administrativ përfundimtar i nxjerrë në procedurën administrative në shkallë të dytë, me të cilin është refuzuar si e pa bazuar kërkesa e subjektit në procedurë N.T.SH "G..." – Rahovec, për rishqyrtimin e vendimit R-22541/06.05.2020 të ZBD Prishtinë, dhe ka lënë në fuqi rivlerësimin e Sektorit të Pranimit Qendror, e kundër të cilit paditësi me padinë e datës 05.08.2020, ka iniciuar kontestin tregtar-administrativ pranë kësaj gjykate.

Nga ekzaminimi i vendimit kontestues, Gjykata konstaton se e paditura Dogana e Kosovës në shkallë të dytë e ka refuzuar kërkesën e subjektit në procedurë këtu paditësit për rishqyrtimin e Deklaratës Unike Doganore R-22541 të datës 06.05.2020, të ZBD Prishtinë. E paditura ka vlerësuar se Sektori i Pranimit Qendror ka vepruar drejtë kur e ka kontestuar vlerën e mallit lëndor, pasi që vlera e mallit e deklaruar për zhdoganim nuk është vlera reale e paguar për mallin me qëllim të importit në vendin tonë për arsye se është deklaruar vlerë më e vogël se sa vlera reale e paguar apo që ka për tu paguar për mallin e shitur për eksport përkatësisht për import në vendin tonë në vështrim të nenit 33 të Kodit Doganor dhe të Akcizave të Kosovës. Tutje theksohet se dokumentacioni përcjellës i mallit lëndor është vlerësuar si provë e pamjaftueshme, pasi që i njëjti as në sistemin ASYCUDA dhe as në procedurën ankimore nuk ka prezantuar deklaratën eksportuese të shtetit eksportues, si dhe mungon Kontrata e Shitblerjes, dhe në këtë kuptim subjekti nuk ka prezantuar gjithë dokumentacionin e nevojshëm për të aplikuar nenin 33 të KDA-së. Prandaj, Dogana e Kosovës ka konstatuar se malli nuk mund të vlerësohet sipas nenit 33 dhe nenit 34 pika a), b) dhe c) të KDA-së, duke sjellë aktvendimin e kontestuar në pajtim me nenin 35 të KDA-së, respektivisht në bazë të dhënave të disponueshme.

Gjykata nga aktvendimi kontestues vëren se ai përmban të meta të cilat e pengojnë vlerësimin e ligjshmërisë së vendimit të kontestuar, te metat e tilla konsistojnë në faktin se arsyetimi i vendimit kontestuese përmban të dhëna të pamjaftueshme dhe jo të plota sa i përket rivlerësimit të mallit lëndor. Në arsyetimin e aktvendimit kontestues nuk është dhënë arsyetim i bazuar, përse nuk është pranuar vlera e transaksionit, kur paditësi ka prezantuar dokumentacionin valid që dëshmon për çmimin e paguar, dhe nuk është

dhënë asnjë provë për tu dëshmuar se paditësi i ka paguar eksportuesit mbi çmimin e faturës së mallit, për të dëshmuar konstatimin e dhënë të vlerës së mallit të deklaruar për zhdoganim nuk duhet t'i pranohet vlera e transaksionit.

Mos vërtetimi i plotë i gjendjes faktike, Gjykata e konsideron faktin se vendimi i kontestuar nuk përmban arsye për faktet vendimtare të vlefshme për gjykimin e drejtë të kësaj çështje juridike-administrative. Në arsyetim të vendimit kontestues, thuhet se Sektori e Pranimit Qendror ka vepruar drejtë kur ka kontestuar vlerën e mallit lëndor, pasi që vlera e mallit e deklaruar për zhdoganim nuk është vlera reale e paguar për mallin me qëllim të importit në vendin tonë, për arsye se është deklaruar vlerë më e vogël se sa vlera reale e paguar apo që ka për tu paguar për mallin e shitur për eksport, përkatësisht për import në vendin tonë, në vështrim të nenit 33, të KDA-së, mirëpo një konstatim i tillë për Gjykatën është tërësisht i pa qëndrueshëm dhe i pa mbështetur në prova materiale, është shumë kontradiktor në vetvete dhe në raport me dokumentacionin e prezantuar, si dhe me bazën ligjore në fuqi, dhe sepse e paditura nuk ka qenë të gjendje të provojë këtë konstatim, kjo edhe përmes ndonjë dëshmie me të cilin do të argumentohej se paditësi nuk i ka paguar eksportuesit përmes transaksionit bankar çmimin e faturave apo se i ka paguar eksportuesit mbi çmimin e faturave blerëse të mallit.

Gjykata ka shqyrtuar vendimin kontestuese dhe pretendimet e paditësit lidhur me mospranimin e vlerës së mallit, duke konstatuar se paditësi ka provuar që me prova bindëse të dëshmoj para Doganës që në kuptim të dokumenteve përcjellëse të prezantuara, paditësi në këtë rast ka prezantuar Urdhërpagesën Ndërkombëtare të realizuar në “...” në vlerë prej 6,912.00 USD të datës 14.01.2020, dhe Urdhërpagesën Ndërkombëtare të realizuar në “...” në vlerë prej 16128.00 USD të datës 15.04.2020, si dhe ka prezantuar Swift Confirmation-MT 103 në vlerë prej 6912.00 USD të datës 14.01.2020, dhe Swift Confirmation-MT 103 në vlerë prej 16128.00 USD të datës 15.04.2020, dhe të cilat janë të harmonizuara në tërësi në kuptim të vlerës dhe të përshkrimit me faturën nr.KD20E004 të datës 23.03.2020. Gjykata vlerëson se legjislacioni doganor nuk përmban dispozita ku thuhet se vlera doganore e mallrave të importuara, duhet të jetë në përputhje me vlerën e të dhënave të disponueshme nga Dogana e Kosovës, në rastet kur ka dokumentacion përcjellës të harmonizuar, por përkundrazi tek neni 33 par.1 të KDA-së është parashikuar se “*Vlera doganore e mallrave të importuara është vlera e transaksionit, që paraqet çmimin vërtetë të paguar*

ose të pagueshëm për mallrat e shitura për eksport në Kosovë, i përshatur, sipas nevojës, në përputhje me nenet 36 dhe 37”.

Gjykata e obligon të paditurën se në rishqyrtim dhe rivendosje, duhet te konstatoj këto pretendime të cekura si më lartë dhe argumentet e paditësit dhe të deklarohe lidhur me provat e administruara përkatësisht Urdhërpagesat Ndërkombëtare të realizuar në “....” të datës 14.01.2020 dhe 15.04.2020, si dhe SWIFT CONFIRMATION-MT 103 të datës 14.01.2020 dhe 15.04.2020, të cilat janë të harmonizuara në tërësi në kuptim të vlerës dhe të përshkrimit me nr.KD20E004 të datës 23.03.2020. Në arsyetimin e vendimit kontestues shihet se e paditura nuk ka shqyrtuar drejtë pretendimet e paditësit për të konstatuar se fatura dhe dokumentet tjera përcjellëse përse janë kontestuar, pra nuk janë marr për bazë dhe nuk i ka pranuar si valide, andaj një akt administrativ i tillë nuk përmban një përmbledhje të konstatimeve faktike bazuar në provat e paraqitura gjatë procedimit administrativ ose në faktet e siguruara nga administrata.

Të metat e mësipërme janë të asaj natyre që e bëjnë të pa mundur vlerësimin e ligjshmërisë së vendimit të kontestuar, prandaj aktvendimi i atakuar u dashtë që doemos të anulohet, tutje Gjykata e obligon të paditurën që në ri procedurë të deklarohe lidhur me provat e paraqitura nga paditësi lidhur me Deklaratën Unike Doganore R-22541 të datës 06.05.2020, të ZBD Prishtinë, dhe të administruar nga Gjykata e të cilat u përmenden më lartë.

Me rastin e nxjerrjes së vendimit të ri, e paditura të vlerësoj drejtë gjendjen faktike që rezulton nga dokumentacioni i mallit të deklarohe lidhur me të dhënat e aplikuar me rastin e rivlerësimit të mallit kontestues dhe të aplikoj drejtë dispozitat ligjore me të cilën përcaktohet vlerësimi i mallrave. Vërejtjet e cekura janë të obligueshme për organin e paditur, duke u bazuar në nenin 65, të Ligjit për Konfliktet Administrative.

Gjykata vendos për çështjen e konfliktit administrativ në bazë të fakteve të vërtetuara në procedurë administrative, në vështrim të nenit 43, paragrafi 1, të LKA-se. Në bazë të këtij parimi, Gjykata e ka të pamundur të vendos në mënyrë meritore në këtë konflikt administrativ për arsye se ekzistojnë të meta të cilat e pengojnë vlerësimin e ligjshmërisë së vendimit të kontestuar, andaj e aprovon padinë e paditësit, anulon aktvendimin e kontestuar, dhe lënda kthehet në rishqyrtim dhe rivendosje. Gjykata

bazuar në autorizimet nga neni 43 par.2 të LKA-së e detyron të paditurën, që në ri procedurë të veproj sipas vërejtjeve të dhëna në arsyetim të këtij aktgjykimi.

Vendimi që secila palë t'i bart shpenzimet e veta procedurale është marrë konform neni 64, të LKA-së.

Duke u bazuar në të dhënat e lartcekura, Gjykata konform dispozitave ligjore të neni 43, par 2, e 46, par 1 dhe 2, të LKA-së, ka vendosur si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA KOMERCIALE

Dhomat e shkallës së parë, Departamenti Fiskal

KF.nr.100/22 datë 10.11.2022

Këshilltare Profesionale
Blerina Qaflehi Baxhaku

Gj y q t a r i,
Fisnik NULI

KËSHILLA JURIDIKE:

Kundër këtij aktgjykimi është e lejuar ankesa, në afat prej 15 ditësh nga marrja e të njëjtit, dhomave të shkallës së dytë, përmes dhomave të shkallës së parë të kësaj gjykate.